

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Mehmet Ndrecaj, me procesmbajtësen Shyrete Sopaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B. Q. nga fshati Komaj - Hax komuna e Prizrenit, për shkak të kryerjes së veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 nën.par. 1.3 KP-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.154/15, dt.12.10.2016, në seancën e shqyrtimit filletar, në prezencën e prokurorit Fatos Ajvazi, të dëmtuarit R. Q. me përfaqësuesin ligjor N. Q. dhe të akuzuarit B. Q., më datë 08.05.2017 publikisht mori dhe shpalli këtë

AKT GJYKIM

I akuzuari;

B. Q. nga i ati M. L., dhe e ëma N. L., e lindur Q. i lindur më datën 20.05.1982, në fshatin Komaj - Hax komuna e Prizrenit ku edhe tani banon i martuar, baba i pesë fëmijëve, bukëpjekës, ka të kyrer shkollën fillore, me kushte të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se më datën 20.09.2014, rreth orës 19:30 min, në fshatin Komaj komuna e Prizrenit, i shkakton lëndime të rënda trupore të dëmtuarit fëmijut R. Q. [Qen], nga i njëjtë fshat, në atë mënyrë që pas një fjalosje të shkurtër përkitazi në rrugën dhe kalimin e saj, pasi që i dëmtuari ishte larguar afërsisht 5 metra nga i pandehuri, ku kishte filluar të qesh dhe e kishte vendosur dorën në buzë, i pandehuri këtë sjellje të dëmtuarit e kishte pranuar si ofendim, derisa në dorë i pandehuri kishte pas një lopatë të cilën e gjuan në drejtim të dëmtuarit, e cila e godet të njëtin në këmbën e djathë - thembren e akilit, me ç'rast i shkakton lëndim të rëndë trupor.

Kështu që ka kyer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 nën. par. 1.3 të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4, 6, 7, 17, 41, 42, 45, dhe 73 të KP-së, të akuzuarit i'a shqipton:

DËNIMIN ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muajve të cilin dënim do t'a vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar R. Q. - përfaqësuesi i tij ligjor nga fshati Komaj - Hax komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civilo-juridik.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës aq sa do të jenë ato sipas llogarisë së arkës së kësaj gjykate, për ekspertizën mjekoligjore 20 euro ndërsa ne emër të paushallit gjyqësor do të paguajnë shumën prej 50 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren në këtë Gjykatë, ka parashtruar aktakuzë PP.nr.154/15, dt.12.10.2016, ndaj të akuzuarit ~~Besa Qemali~~ nga fshati ~~Pomaj~~ komuna e Prizrenit për shkak të kryerjes së veprës penale lëndim i rëndë trupor nga nen 189 par.1 nën. par. 1.3 të KP-së.

Gjykata më datën 08.05.2017 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ku ka prezantuar e prokurori i shtetit i dëmtuarit sëbashku me përfaqësuesin ligjor dhe i akuzuari. Pas kësaj është lexuar atakuza nga ana e Prokurorit të Shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provat materiale në të cilat mbështetë aktakuza. I akuzuari ka dekluaruar se e ka kupuar aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer dhe pranueshmërinë e provave, duke shtuar se i vije keq për këtë vepër që ka kryer, dhe në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla.

Gjykata ka vërtetuar këtë gjendja faktike:

Se më datën 20.09.2014, rrëth orës 19:30 min, në fshatin ~~Pomaj~~ komuna e Prizrenit, i shkakton lëndime të rënda trupore të dëmtuarit fëmijut ~~Ramush Qemali~~, nga i njëjtë fshat, në atë mënyrë që pas një fjalosje të shkurtër përkitazi në rrugën dhe kalimin e saj, pasi që i dëmtuarit ishte larguar afërsisht 5 metra nga i pandehuri, ku kishte filluar të qesh dhe e kishte vendosur dorën në buzë, i pandehuri këtë sjellje të dëmtuarit e kishte pranuar si ofendim, derisa në dorë i pandehuri kishte pas një lopatë të cilën e gjuan në drejtim të dëmtuarit, e cila e godet të njëtin në këmbën e djathtë - thembren e akilit, me ç'rast i shkakton lëndim i rëndë trupor.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat, gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari e ka kupuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit dhe çdo provë tjeter, dhe se aktakuza nuk përbante asnje shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruara si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin t'a shpall fajtor dhe t'a gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.


Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes se lartësisë së dënimit për të akuzuarin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KP-së, si rrethanë lehtësuese e vlerësoj: pranimin e fajësisë, është penduar për veprën e kryer, ka pasur sjellje korrekte në gjykim, ndërsa si rrethana rënduese gjykata e vlerësoj vendin, kohën dhe mënyrën dhe rrethana se si është kryer vepra penale, mjeti i kryerjes së veprës penale, vepra është kyrer ndaj personit të ndjshëm të mitur pra edhe pse gjykata ka konstatuar se ka pasur rrethana tejet rënduese në raport me të akuzuarit, i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se me dënimet e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimis, që të parandaloj kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, në parandalimin e personave te tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligit, dhe nga te gjitha këto ka konsideruar se dënimis i shqiptuar është ne përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprat penale për të akuzuarin.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori konform neneve 450 dhe 451 të KPP-së, ndërsa udhëzimi i palës se dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike ne kontest civil u mbështet ne nenin 463 te KPP-së.

Nga theksimet e theksuara me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2197/16, dt.08.05.2017

Procesmbajtësja
Shyrete Sopaj



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh prej ditës së pranimit te këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit ne Prishtinë.